



Center for Social Group Development
Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore



CEL
Center for Equality and Liberty
K O S O V A

Raporti vjetor, Godišnji izveštaj, Annual Report 2018

Personat LGBTI dhe të drejtat e tyre në Kosovë

LGBTI osobe i njihova prava na Kosovu

The LGBTI persons and their rights in Kosovo



European
Union
Kosovo



Personat LGBTI dhe të drejtat e tyre në Kosovë

Raporti vjetor 2018




Botues:

Qendra për zhvillimin e grupeve shoqërore – CSGD
CEL - Center for Equality and Liberty

Dizajni & shtypi:

ASHA Graphics

Kopje:

300

Deklaratë Mohimi

Ky publikim është prodhuar me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e CSGD & CEL dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Të drejtat e autorit

© CSGD & CEL, dhjetor 2018. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtëritëse ose të transmetohet në çfarëdo forme apo me çfarëdo lloj mjeti, elektronik, mekanik, foto-kopjim, regjistruar apo tjetër, pa lejen paraprake të CSGD & CEL.



Përmbajtja

Shkurtesat	6
Përmbledhje Ekzekutive.....	7
Hyrje	8
Legjislacioni	9
Përgjegjësia institucionale ndaj të drejtave LGBTI	11
Zbatimi i legjislacionit për të drejtat e LGBTI	13
Institucionet dhe mekanizmat e të drejtave të njeriut që merren me të drejtat e LGBTI	13
Raportimi në Media për çështjet e LGBTI	14
Kontributi i organizatave të LGBTI	15
Sulmet ndaj aktivistëve të LGBTI	17
Rastet e raportuara në institucione përkatëse	17
Rekomandimet	18

Shkurtesat

ARC	Agjencioni për Regjistrim Civil
CEL	Qendra për Barazi dhe Liri
CSGD	Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore
ERAC	Koalicioni Drejta të Barabarta për tëGjithë
GKK	Grupi Këshillëdhënës dhe Koordinues për të drejtat LGBT
IAK	Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës
IDAHOT	Dita Ndërkombëtare kundër Homofobisë dhe Transfobisë
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
KPRK	Kodi Penal i Republikës së Kosovës
LGBTI	Lezbike, Gej, Bisexual, Transgjinnor dhe Interseks
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
ZQM	Zyra për Qeverisje të Mirë (zyra për Qeverisje të Mirë, Drejtat e Njeriut, Mundësi të Barabarta, dhe Jo-Diskriminin)

Përmbledhje Ekzekutive

Megjithëse ka pasë ndryshime pozitive në vitet e fundit për avancimin e të drejtave LGBTI, dhe përkundër që kushtetuta edhe disa ligje sigurojnë mbrojtje të avancuara ligjore, lëvizja LGBTI ende ballafaqohet me shumë pengesa kur bëhet fjalë për praninë dhe tolerancë. Edhe pse institucionet janë aktorë të parë për të ofruar trajtim tënjëjtë ndaj qytetarëve të Kosovës, në tëkundërtën ato po implementojnë ligje sipas besimeve të tyre personale, e jo çka po sigurojnë ligjet. Nganjëherë duket që plotësimi ndryshimi i ligjeve është vetëm sa për të plotësuar një kriter siç është "sigurimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut"si parakusht për Integrim Evropian sesa realiteti i gjithëpërfshirës.

Në përputhje me këtë, kjo pikëpamje perceptohet nga publiku në përgjithësi që çështjet e personave LGBTI janë të importuara nga ndërkombëtarët dhe jo realiteti i luftës së personave LGBTI për të drejtat e tyre në Kosovë¹. Rrjedhimisht, personat LGBTI detyrohen të bëjnë jetë të dyfishtë, duke jetuar me friken se do bëhen subjekte të diskriminimit dhe dhunës.

Ky raport do ilustrojë realitetin e personave LGBTI në të gjitha aspektet e të drejtave të tyre. Raporti paraqet një përmbledhje

të qartë të veprimeve të ndërmarra nga aktorët përkatës në sigurimin e mbrojtjes dhe zbatimit të ligjeve në vend, po ashtu avancimin e ligjeve përkatëse që sigurojnë të drejta të barabarta të personave LGBTI me shoqërinë e përgjithshme. Raporti fillon me një hyrje të analizimit të situatës të të drejtave të personave LGBTI, dhe vazhdon me një analizë të shkurtër ligjore. Kjo do pasqyrojë përcjelljen e ndryshimeve pozitive të plotësimi ndryshimeve të Kodit Penal të Kosovës dhe po ashtu procesin ligjor tënjohjes së gjinisë. Me tutje, raporti shqyrton përpjekjet dhe përkushtimin e institucioneve përkatëse në realizimin e përgjegjësisë të tyre tëmandatuara drejt të drejtave LGBTI.

Për më tepër, ky raport gjithashtu ilustron rolin e mediave, duke theksuar ndryshimet pozitive të bëra viteve të fundit, gjuhën e urrejtjes të shumë përhapur, dhe përmbajtjen e pakontrollueshme në pjesën e komenteve, si dhe rolin e mediave në ngritjen e vetëdijes. Raporti pasqyron veprimet e ndërmarra nga organizatat e LGBTI për të plotësuar nevojat e identifikuara, si dhe shembujt e presionit dhe kërcënimeve ndaj aktivistëve për të drejtat e LGBTI. Në fund, raporti përmbledhë rastet e raportuara të dhunës ndaj personave LGBTI dhe përfundon me një listë të rekomandimeve për institucione përkatëse.

1 Instituti Demokratik Kombëtar, *Sondazhi Opinioni për LGBTI në Ballkanin Perëndimor, Qershor/Korrik 2015*, (2015), https://www.ndi.org/LGBTI_Balkans_poll

Hyrje

Avancimi i të drejtave të Lezbikeve, Gejve, Biseksualëve, Transgjignorëve dhe Interseksëve (LGBTI) mbetet sfidë për të gjithë aktoret e përfshirë në çështjet e LGBTI dhe ka ende një rrugë të gjatë deri te vendosja e barazisë në vend. Shoqëria Kosovare buron nga një sistem patriarkal që ka ndikim të madh në jetë të përditshme, duke e bërë kështu të vështirë paraqitjen në publik e ndonjë gjë tjetër që nuk është brenda normave tradicionale. Si e tillë, gjithashtu e benë të vështirë edhe për institucione t'i zbatojnë ligjet në vend. Megjithatë, lëvizja LGBTI viteve të fundit ka bërë disa ndryshime pozitive në jetën e personave LGBTI.

Aktivistet LGBTI, gjatë vitit 2018 kanë qenë më të dukshëm në media, duke i ngritur çështjet LGBTI në një masë më të dukshme dhe me të gjerë. Kjo megjithatë është kundërshtuar nga shoqëria dhe aktivistet u bënë subjekt i kërcënimeve dhe gjuhës së urrejtjes. Media, gjatë këtij viti, ka pasë disa ndryshime pozitive, ku televizionet dhe disa medime tjera u bënë ftesë aktivistëve të LGBTI të marrin pjesë në emisionet e tyre për të pasqyruar dhe promovuar aktivitetet dhe për të ngritur edhe me tej vetëdijen në publik të gjerë.

Edhe pse Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit ka një mandat për të promovuar të drejtat e LGBTI, në Ditën Ndërkombëtare

Kundër Homofobisë dhe Transfobisë me 17 Maj 2018, ZQM-ja u pajtua të ndriçojë ndërtesën e Qeverisë me flamurin e ylberit, megjithatë, kjo zyre vetëm e kontrakttojë një kompani për të kryer këtë punë dhe askush nga kjo zyre nuk mori pjesë në ceremoni, përkundër faktit që kjo ceremoni ishte aktivitet zyrtar i propozuar dhe organizuar nga vet ZQM-ja. Për me tepër, gjatë Javës së Krenarisë, Kryesuesi i ZQM-së dhe një përfaqësues i ZQM-së ishin të ftuar në dy panele të konferencës "Përmirësimi i të drejtave LGBTI - "Çka shkoi gabim dhe çka mund të bëjmë ndryshe" për të cilën ata kishin konfirmuar pjesëmarrjen, vetëm njëri përfaqësues mori pjesë ndërsa Kryesuesi i ZQM-së e injoroi ftesën dhe nuk mori pjesë fare, pa ndonjë njoftim paraprak. Kjo tregon mungesë të zotimit nga institucionet e Kosovës kur duhet të flitet publikisht për çështjet LGBTI.

Ky raport ofron një vështrim gjithëpërfshirës të vitit 2018, pasi që paraqet diskutimet e zhvillimeve ligjore dhe institucionale për të drejtat LGBTI si dhe një përmbledhje të veprimeve të ndërmarra nga organizatat e shoqërisë civile. Raporti përfundon me një përshkrim të shkurtër të krimeve të urrejtjes, rasteve të gjuhës së urrejtjes dhe kërcënimeve të raportuara nga personat LGBTI gjatë vitit raportues.

Legjislacioni

Korniza ligjore e Kosovës siguron garanci të avancuara për të drejtat e njeriut të harmonizuara me standardet ndërkombëtare. Kushtetuta qëndron në parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit² e cila në mënyrë eksplicite ndalon diskriminimin në një sërë bazash përfshirë gjininë dhe orientimin seksual³. Këto parime janë të fortifikuara më tej me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi⁴ dhe Ligjin për Barazi Gjinore⁵. Teorikisht, kushtetuta lejon që shumica e marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut⁶ të zbatohen në sistemin ligjor të Kosovës dhe mundëson interpretimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në koherencë me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut⁷.

Në kundërshtim me parimin e barazisë siç përcaktohet me Kushtetutë⁸, personat LGBTI janë të ndaluar të lidhin martesë të ligjshme. Kjo për shkak që Ligji për Familjen e kufizon aktin e fejesës dhe martesës vetëm për persona me gjini të kundërt⁹. Megjithatë, në dhjetor të vitit 2018, në

anëtar i stafit të Qendres për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore (CSGD) mori pjesë në një punëtori të grupit punues për hartimin e Kodit Civil në të cilin do të përfshihen edhe Ligji i Familjes. Por, edhe pse para-prakisht e planifikuar asgjë nuk u diskutua në lidhje me martesën, megjithatë, në fillim të vitit 2019, CSGD do inicojë takime me institucione relevante si përpjekje për të ndryshur këtë kufizim që tani ndodhet në ligj.

Ligjit për Statusin Civil¹⁰ i mungon dispozita ligjore dhe nënligjore për procesin e ndrrimit të gjinisë që mbulon modifikimin e të dhënave në regjistrat dhe dokumentet publike.¹¹ Duke filluar që nga viti 2017 dhe duke vazhduar edhe në vitin 2018, CSGD-ja mbajti disa takime me përfaqësues të Agjencionit për Regjistrim Civil (ARC) dhe të Ministrisë për Punë të Brendshme (MPB) duke kërkuar kështu plotësim ndryshim të Ligjit për Statusin Civil dhe hartimin e një udhëzimi administrativ që do mundësonin ndryshimin e shënimit gjinor në dokumentet e identifikimit, dhe ripërcaktimin e njohjes ligjore të gjinisë. Në fillim të vitit 2018, ky ligj është dërguar për ndryshim,

2 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, c.I, neni 7 (1).

3 *Ibid*, c. II, neni 24 (2).

4 Ligji Nr. 05/L-021.

5 Ligji Nr. 05/L-020.

6 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, c. II, neni 22.

7 *Ibid*, c. II, neni 53.

8 *Ibid*, c. II, neni 24, neni 37.

9 Ligji Nr. 2004/32 Ligji për Familjen Kosovës, 2006, Pjesa II, c. I, neni 9, neni 14.

10 Ligji Nr. 04/L-003.

11 Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore dhe Qendra për Barazi dhe Liri, *Raport: Mbrojtjes sociale dhe qasje në kujdesin shëndetësor për persona transgjininor në Kosovë*, (Prishtina, Kosovë, Dhjetor 2016).

//////////

dhe ARC ka kërkuar ndihmën e CSGD për të organizuar punëtori për hartimin e udhëzimit administrativ për të mundësuar ndryshimin e shënimit gjinor në dokumentet e identifikimit, duke ridefinuar njohjen ligjore të gjinisë. Gjatë pesë muajve të fundit ARC dhe MPB nuk u takuan me përfaqësuesit e CSGD me arsyetimin se ata janë duke pritur për themelimin e grupit punues¹² që do të ndryshonte ligjin dhe do të hartonte aktin nënligjor i cili do të rregullonte ndryshimin e seksit/gjinisë në dokumentet zyrtare.

Kodi i ri Penal i Republikës së Kosovës (KPRK) është votuar nga Kuvendi i Kosovës dhe është dekretuar nga Presidenti më 28 Dhjetor 2018. Kodi i ri Penal do të hyjë në fuqi më 15 Prill 2019. Si rezultat, krimet e urrejtjes u përfshinë në Nenin 70 (Rregullat e përgjithshme për zbutjen ose ashpërsimin e dënimeve). Rekomandimi për përfshirjen e orientimit seksual dhe identitetit gjinor si bazë mbrojtëse në Nenin 147 (Nxitja e ur-

rejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik) u refuzua me arsyetimin se si e tillë nuk është theksuar në mënyrë eksplicite në asnjë shtet të Këshillit të Evropës. Baza e orientimit seksual dhe identitetit gjinor u përfshinë në Nenin 141 (Nxitja e përçarjes dhe mosdurimit), Nenin 173 (Vrasja e rëndë), Nenin 184 (Sulmi), Nenin 185 (Lëndimi i lehtë trupor), Nenin 186 (Lëndimi i rëndë trupor), Nenin 190 (Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës) dhe Nenin 321 (Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë).

Megjithëse ka nevojë për avokim të vazhdueshëm për ndryshimin e ligjeve për arritjen e barazisë për personat LGBTI, legjislacioni në Kosovë është mjaft i avancuar kur është fjala për sigurimin e mbrojtjes kundër diskriminimit. Megjithatë, zbatimi i ligjeve të tilla mbetet i ulët ose nuk zbatohet fare.

12 ErdonArifaj, "RE: Kerkese " [RE: Request], Email to CSGD, 30 July 2018.

Përgjegjësia institucionale ndaj të drejtave të LGBTI

Në përputhje me detyrimet kushtetuese për të promovuar barazinë dhe të drejtat e njeriut, Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi iu bashkua paradës së parë të krenarisë në Kosovë, mbajtur më 10 tetor 2017. Ai, gjithashtu, mori pjesë në marshin e 2016-ës për shënimin e Ditës Ndërkombëtare kundër Homofobisë dhe Transfobisë (IDA-HOT). Megjithatë, në Paraden e Krenarisë së këtij viti, Presidenti i Kosovës nuk mundi t'i bashkohej pasi ai ishte jashtë vendit për një vizitë zyrtare në Armeni. Pavarësisht nga mungesa e tij, zoti Thaçi uroi paradën përmes mediave sociale në "Tëitter" ku shkroi: "Urimet më të mira nga #Yerevan, një rëzve që po festojnë dashurinë dhe të drejtat njerëzore në #Prishtinë, sot për #ParadënPrishtina. Vtën e kaluar unë mora pjesë në eventin që thekson barazinë për të gjithë në republikën tonë, së bashku me @UlrikeLunacek&@USAmbKosovoDelaëie. #LGBTQ#nëemërtëlisë". Mesazhet e Presidentit në Tëitter patën ndikimin e tyre pozitive tek popullata e gjërë, por jo aq tërëndësishëm se sa kur ai fizikisht ishte pjesëmarrës në Paraden e Parë të Krenarisë në vitin 2017. The "tëets" of the President had a positive impact on it's own to the wider population, but not as significant as when he physically participated in the First Pride Parade in 2017. Avokimi publik për të drejtat LGBTI nga përfaqësuesit e lartë institucionalë dhe politikë është më se i nevojshëm në luftën për barazi dhe

avancimin e të drejtave të njeriut, prandaj pjesëmarrja e presidentit dhe udhëheqësve të tjerë në paradën e krenarisë demonstroi një angazhim pozitiv në këtë drejtim.

Në vitet e kaluara Kuvendi i Kosovës premtoi të promovojë dhe sigurojë zbatimin e ligjeve ekzistuese, gjatë vitit 2018 asambleja nuk ka iniciuar ndonjë takim apo aktivitet lidhur me të drejtat LGBTI.

Qeveria e Kosovës ka vazhduar të adresojë të drejtat LGBTI përmes mekanizmit të tij ekzistues, përkatësisht Grupit Këshilldhënës dhe Koordinues për të drejtat LGBTI në Kosovë (GKK, që vepron nën mandatin e ZQM. Megjithatë në vitin e kaluar, për Javën e Krenarisë në tetor 2017, GKK arriti të organizojë një pritje në të cilën Kryeministri i Kosovës, z. Ramush Haradinaj, rikonfirmoi angazhimin e Qeverisë së Kosovës për avancimin dhe mbrojtjen e LGBTI, në Javën e Krenarisë të vitit 2018, GKK jo vetëm që nuk arriti të organizonte asgjë për të shënuar Javën e Krenarisë këtë vit, por edhe pas konfirmimit të pjesëmarrjes së saj në dy diskutime të organizuara nga organizatat LGBTI, ata nuk u paraqitën në asnjë prej tyre, pa asnjë njoftim. Gjithashtu, drejtori i ZQM nuk është paraqitur në konferencën e organizuar nga CEL, në qershor 2018, edhe pse e ka konfirmuar pjesëmarrjen në panel të kësaj konference.

GKK mbajti vetëm dy takime në vitin 2018. Në takimin e parë, më 11 maj, GKK diskutoi rreth shënimit të IDAHOT, ku ZQM-ja ra

////////////////////

dakord të ndriçonte ndërtesën e qeverisë me flamurin e ylberit, pasuar nga një ceremoni për të cilën ftuan palë relevante të interesit për të marrë pjesë. Në ceremonipjesëmarres ishin organizatat LGBTI dhe Ambasadori i Shteteve të Bashkuara. Në takimin e dytë, më 27 shtator, grupi u mbledh për të diskutuar rreth koordinimit të aktiviteteve për Javën e Krenarisë 2018, megjithatë, anëtarët e GKK që përfaqësojnë institucionet qeveritare dhe publike nuk morën pjesë në asnjë nga aktivitetet, ngjarjet publike apo fushatat që promovojnë të drejtat LGBTI.

GKK ende nuk ka rregulla dhe procedura që ndikojnë në funksionalitetin e tyre sidomos në aspektin e llogaridhënies dhe vendimmarrjes. GKK nuk ka qenë në gjendje të monitorojë zbatimin e rekomandimeve të veta ndaj institucioneve të tjera dhe kështu ndikimi në institucionet e tjera mbetet i diskutueshëm. Gjithashtu, sa i përket Planit Kombëtar të Punës për Grupin Këshillues dhe Koordinues për të Drejtat e komunitetit LGBTI, nuk po adresohet dhe nuk po aplikohet siç duhet. Plani Kombëtar i Punës ka përfunduar në nëntor 2018, dhe nuk ka asnjë indikacion se GKK do të hartojë Planin e ardhshëm Kombëtar të

Punës. CSGD do të publikojë një raport mbi zbatimin e këtij Plani të Punës gjatë vitit 2019. Megjithatë, asnjë informacion mbi punën e GKK, as puna apo aktivitetet e ZQM-së në lidhje me të drejtat/çështjet LGBTI nuk mund të gjenden në faqen zyrtare te internetit të ZQM-së.

Përderisa faqja zyrtare e internetit të GKK përmban një numër të madh të strategjive dhe plane të punës të ndryshme dhe dokumente tjera relevante për mandatin e GKK-së, Plani Kombëtar i Punës së GKK ende mungon dhe ky dokument nuk mund të gjindet askund tjetër përpos në faqen zyrtare të internetit të CSGD¹³.

Kryetari i Komunës së Prishtinës, Z. Shpend Ahmeti, njëherit edhe kryetari i Partisë Social Demokrate të Kosovës, mori pjesë në Paradën e Krenarisë të këtij viti. Me një deklaratë në media, ai kërkoi nga të gjithë politikanët në pozitëdhë opozitë të “dalin hapur” dhe të deklarojnë qëndrimin e tyre për çështjen e të drejtave njerëzore të personave LGBTI. Për më tepër ai tha se beson që çdo qytetar i Prishtinës dhe Kosovës duhet të jetë i lirë dhe të jetojë nëpaqë.

13 <http://csgd-ks.org/wp-content/uploads/2017/03/Plani-i-punes-GKK-ZQM-ZKM.pdf>

Zbatimi i Ligjit për të drejtat LGBTI

Policia e Kosovës ka vazhduar të bëjë një punë të shkëlqyer edhe gjatë vitit 2018 për të siguruar mbrojtjen e personave LGBTI si dhe aktivitetet e organizuara nga organizatat LGBTI. Është e rëndësishme të përmendet se gjatë vitit 2018 ka pasur një rast ku Policia e Kosovës ka marrë masat e nevojshme ndaj pesë policëve të cilët janë pezulluar për shkak të mungesës së profesionalizmit dhe shkeljes së privatësisë ndaj dy personave LGBTI.

Asnjë rast i ri nuk është sjellë në gjykatë gjatë vitit 2018. Megjithatë, është vështirë të përcjellen rastet pasi ato të raportohen në polici. Nuk ekziston një sistem ndjekës për të dhënat lidhur me rastet e krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTI në prokurori dhe gjykata.

Institucionet dhe mekanizmat për të drejtat e njeriut gjatë punës së tyre me të drejtat e LGBTI

Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës (IAK) ka qenë më i vëmendshëm ndaj të drejtave LGBTI dhe ka pasur një bashkëpunim më të mirë me organizatat LGBTI krahasuar me vitet e kaluara. Të drejtat e LGBTI iu kushtuan vëmendje të konsider-

ueshme në raportin vjetor të IOK-së¹⁴, të botuar në mars 2018, në të cilin Avokati i Popullit shpjegon rastin e AmicusCuriae dërguar Gjykatës Themelore në Prishtinë¹⁵“veprat penale të kryera kundër anëtarëve të komunitetit LGBT pranohen nga institucionet përgjegjëse në fazën e parë dhe më tej trajtohen si vepra penale të përcaktuara me Kodin Penal, por pa ngritur çështjen se këto vepra janë drejtuar kundër anëtarëve të komunitetit LGBTI, të motivuar dhe të kryer në bazë të urrejtjes kundër orientimit seksual dhe identitetit gjinor, Avokati i Popullit konsideron se dispozitat për ndalimin e diskriminimit për çdo arsye, veçanërisht në bazë të orientimit seksual, duhet të jenë reciprok me nenin 74 të Kodit Penal, i cili përcakton ashpërsinë, më saktësisht në paragrafin 2, pika 2.12”.

Për më tepër, gjatë vitit 2018, një njeri transgjinor u përpoq të ndryshonte emrin dhe shenjën e gjinisë në dokumentet e tij të identifikimit në Zyrën e Statusit Civil në Gjakovë, një kërkesë e cila ishte refuzuar me rekomandimin e ARC-së. Ai e apeloj vendimin drejtpërsëdrejti në Agjenci, por apeli i Morinës u refuzua dhe u cilësua si “pa bazë”, megjithatë, pas kësaj, rasti u dërgua në Gjykatën Kushtetuese, ku IAP u përfshijë në rast si një amicuscuriae (mik i gjykatës), duke ndihmuar gjykatën kushtetuese në ofrimin e informacionit dhe ekspertizës¹⁶.

14 <https://oik-rks.org/2018/04/17/raporti-vjetor-2017/>

15 Opinion Juridiki Avokatit të Popullit lidhur me çështjen e homofobisë dhe transfobisë, idorezuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë me 2 Maj 2017.

16 <https://kosovotwopointzero.com/transgender-case-taken-to-kosovos-highest-legal-institution/>

Raportimi i çështjeve LGBTI nëMedia

Media ka ndryshuar në mënyrë drastike qasjen në lidhje me trajtimin objektiv dhe të drejtë të personave LGBTI përsa u përket artikujve që janë duke u botuar ose transmetuar, dhe janë dukshëm më të respektueshme sesa ato dikur. Sidoqoftë, ndihma për qëndrimet publike mbetet e ulët sidomos në platformat e mediave sociale ku ka një përhapje të gjerë të gjuhës së urrejtjes dhe përmbajtjes së pakontrollueshme në pjesën e komenteve.

Personat LGBTI ende janë të nën-përfaqësuar në media kosovare, veçanërisht kur flitet për tregimet dhe identitetet e tyre. Në vitin e kaluar vërehet se gazetarët janë përmirësuar ndjeshëm në raportimet që kanë të bëjnë me personat LGBTI, megjithatë, ka ende shumë keqkuptime nga ana e tyre kur bëhet fjalë për përdorimin e përemrave të përshtatshëm për personat trans, identitetet e tyre janë të nën-përfaqësuar dhe kur ato përfaqësohen janë

të pasakta, stereotipike dhe madje të dëmshme për shkak se nuk ka një kuptim të qartë nga ana e tyre në lidhje me Identitetin Gjinor, Orientimin Seksual, Shprehjen Gjinore, ndërkohë që mbetet një stigmë e përhapur dhe diskriminim ndaj personave LGBTI.

Është e pamohueshme që ka nevojë për organizimin e punëtoriveme fokus në zhvillimin e strategjive efektive, të ndjeshme dhe gjithëpërfshirëse të komunikimit për gazetarët dhe profesionistët e medias që merren me çështje të tilla dhe për të përdorur mediat si një mjet për ndryshimin e qëndrimeve publike në avancimin e të drejtave LGBTI në Kosovë

Sipas një monitorimi të mediave të bërë nga CSGD-janë periudhën janar - nëntor 2018, ka pasur 359 raporte për çështjet LGBTI në të gjitha mediat në internet, pothuajse të gjitha të cilat ishin pozitive ose neutrale me shumë pak që ishin negative. Në aspektin e mediave online, IndexOnline kishte qasjen më pozitive, pasuar nga “Bota Sot” dhe “Insajderi”.

Kontributi i organizatave LGBTI

Organizatat LGBTI vazhdojnë të punojnë në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave LGBTI në Kosovë. Në fushën e avokimit CSGD është angazhuar në plotësim ndryshimin e KPRK-së dhe atë të njohjes ligjore të gjinisë, ndërsa puna e Qendrës për Barazi dhe Liri (CEL), nga ana tjetër, përfshiu avokimin nëpërmjet ngritjes së vetëdijes. Megjithëse ka pasur vetëm një rast që është dërguar në gjykatë, kapacitetet lidhur me krimet e urrejtjes kundër personave LGBTI ende duhet të rriten në mesin e gjyqtarëve. CEL organizoi një trajnim me gjyqtarë më 8 maj 2018 në Prishtinë, ku morën pjesë shtatë gjyqtarë të gjykatave themelore nga komunat e ndryshme të Kosovës. Trajnimi u fokusua në instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, hapat praktikë, rastet praktike, rolin e gjyqtarëve në mbrojtjen e të drejtave të personave LGBT.

Në anën tjetër, fuqizimi i lëvizjes LGBTI u arrit nëpërmjet aktiviteteve të ndërtimit të komunitetit. CSGD dhe CEL janë përqendruar në rritjen e kapaciteteve të personave LGBTI për t'u organizuar si aktivistë për të avokuar në përmirësimin e të drejtave dhe mirëqenies së personave LGBTI, për të ndërtuar aktivizimin social në mesin e personave LGBTI, për t'i inkurajuar ata të vënë në pyetje normat shoqërore dhe gjithashtu t'i mbështesë

atanëndonjë vështirësi apo shqetësim që mund të kenë. Kjo bëhet përmes një sërë trajnimesh, punëtorish, diskutimeve grupore, aktiviteteve sociale dhe programeve të rrjetëzimit. Këtë vit CSGD filloi një program i cili është përqendruar në fuqizimin e personave të rinj LGBTI si liderë dhe aktivistë të ardhshëm. Ky program synon të ndërtojë kapacitete të personave dhe liderëve të rinj LGBTI për planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e programeve të punës zhvillimore me njerëz LGBTI në komunitetet e tyre.

Me qëllim të rritjes së rrethit të rrjetëzimit të personave LGBTI dhe fuqizimit të tyre si aktivistë socialë, shumë persona morën pjesë në paradat e krenarisë në rajon. Për më tepër, gjatë procesit të organizimit të "Ditës Ndërkombëtare Kundër Homofobisë dhe Transfobisë- IDAHOT" dhe "Paradën e Krenarisë", CSGD angazhoi shumë persona LGBTI si vullnetarë, ku ata ishin pjesë aktive e procesit të organizimit.

Gjithashtu, me shtrirjen e gjuhës së urrejtjes, e cila shpesh shndërrohet në krime të urrejtjes dhe njohuritë e kufizuara të personave LGBTI për sa i përket disponueshmërisë së mbrojtjes dhe procedurave të duhura ligjore, CSGD ka organizuar një fushatë informuese e cila ka dhënë informacion se ku mund të raportohen rastet e krimit të urrejtjes, hapat që duhet ndjekur dhe shërbimet e ndihmës ligjore falas të ofruara nga organizatat LGBTI në Kosovë. Sigurimi i ndihmës juridike nga CSGD ishte

në dispozicion të viktimave LGBTI pavarësisht nga natyra e shkeljeve.

Pas Paradës së Krenarisë së vitit të kaluar, dhe tri marsheve para kësaj, organizatat LGBTI mbajtën për të dytën herë Javën e Krenarisë në Prishtinë. Qindra njerëz (më shumë se 600) që mbështesin kauzën e të drejtave të LGBTI marshuan nëpër bulevardin dhe sheshin kryesor të Prishtinës, për të protestuar kundër homofobisë dhe transfobisë në vend dhe për të festuar diversitetin e personave LGBTI. Duke qenë parada e vetme e krenarisë në Ballkan pa barrikada, marshimi përfundoi pa incidente. Mes shumë zyrtarëve institucional vendas që morën pjesë në paradën e Krenarisë, pati edhe një shfaqje të madhe të mbështetjes nga bashkësia ndërkombëtare, kryesisht nga përfaqësuesit e Ambasadave dhe nga institucionet dhe organizatat ndërkombëtare. Për më tepër, Ambasada e Mbretërisë së Holandës solli në Kosovë Ambasadorin e Paradës nga Amsterdami, z. Hans Verhoeven. Z. Verhoeven zhvilloi disa aktivitete për të mbështetur Javën e Krenarisë, megjithatë disa nga ato aktivitete dhe postime në profilin e Facebook-ut të Z. Verhoeven u panë në mënyrë të keqe nga ana e publikut, gjë që dëmtoi pak imazhin e Javës së Krenarisë¹⁷.

Megjithatë, duhet të pranohet mbështetja masive e organizatave LGBTI nga Shqipëria, Serbia, Maqedonia, Mali i Zi dhe Bosnja.

Meqenëse një prej objektivave kryesore të organizatës është të fuqizojë personat LGBTI dhe të rrisë mirëqenien e tyre, CSGD vazhdon të ofrojë mbështetje psikologjike për personat LGBTI të cilët kanë hasur vështirësi dhe po luftojnë me çështjet e shëndetit mendor. CSGD zakonisht promovon shërbimet psiko-sociale në qendrën "Drop-In" ku mbahen shumë diskutime lidhur me çështjet e shëndetit mendor. Përveç kësaj, për të arritur tek personat e tjerë LGBTI që nuk frekuentojnë qendrën, shërbimet gjithashtu promovohen edhe në komunitetet lokale ku punëtorët në terren veprojnë dhe shpërndajnë materiale shëndetësore që lidhen me seksin e sigurt.

Sipas të dhënave të grumbulluara nga psikologët të cilët janë angazhuar nga CSGD për seanca psikologjike për personat LGBTI, klientët që kanë mbajtur seanca psikologjike, psikoterapi, gjatë periudhës janar-nëntor kanë paraqitur çrregullime ankthi, çrregullime të përshtatjes, çrregullime të stresit akut dhe çrregullime të gjendjes shpirtërore, depresion.

17 Minutat e takimit të organizuar nga CSGD dhe CEL – Vlerësimi I Javës së Krenarisë, 5 nëntor 2018

Sulmet ndaj aktivisteve LGBTI

Gjatë vitit 2018 nuk ka pasur ndonjë rast të dhunës ndaj aktivistëve të LGBTI. Ka vetëm

raste të ngacmimeve dhe kërcënimeve pas aktiviteteve të bëra publike të kryera nga organizata. Rastet e tilla janë raportuar në polici.

Raportimi i rasteve para institucioneve përkatëse

Personat LGBTI vazhdojnë të kenë frikë ose mosbesim tek institucionet e sundimit të ligjit në Kosovë¹⁸. Megjithatë, gjatë vitit 2018 ka më shumë raste që janë raportuar në polici sesa në organizata. Organizatat LGBTI vazhdojnë të ofrojnë ndihmë juridike falas personave LGBTI dhe në vazhdimësi tentojnë të këshillojnë personat LGBTI të raportojnë rastet e tyre në polici, gjë që

automatikisht do rrisë besimin në institucione.

Sipas policisë, katër raste janë raportuar gjatë vitit 2018. Dy nga këto raste janë raportuar në Drenas/Gllogovc, dhe dy të tjera në Prishtinë. Është më rëndësi të thuhet se incidenti që ka ndodhur me pesë zyrtarët e policisë të cilën më pastaj janë suspenduar nga puna për mungesë profesionalizmi është në vazhdim e sipër, dhe Inspektorati i Policisë së Kosovës (IPK) po merret me rastin¹⁹.

18 Instituti Demokratik Kombëtar, Sondazhi Opinioni për LGBTI në Ballkanin Perëndimor, Qershor/Korrik 2015, (2015), https://www.ndi.org/LGBTI_Balkans_poll

19 Salih Dragidella, "RE: Lidhur me rastet e raportuara" [RE: Regarding the reported cases], Email to CSGD, 19 December 2018.

Rekomandimet

1. Ministria për Punë të Brendshme dhe Agjencioni për Regjistrim Civil duhet të rishikojnë legjislacionin primar dhe sekondar në mënyrë që t'iu bëhet e mundur personave transgjidorndrimi i shënimit të seksit në dokumente identifikimi;
2. Ligji për Familjen duhet të rishikohet në kuadër të pakos së Kodit Civil dhe të parasheh martesën dy personave apo bashkëshortëve të gjinisë neutrale;
3. IAK-u duhet të jetë me zëshëm dhe mëvizibil në promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave LGBTI.
4. IAK-u duhet të angazhohet në grupin punues për Pakon e Familjes në Kodin Civil të promovojë konceptet neutrale të gjinisë për martesën dhe partneritetin;
5. ZQM-ja duhet të mbikëqyr në mënyrë efektive ministritë e linjës për progresin e zbatimit të rekomandimeve të GKK-së, dhe kurdo që është nevoja të ndër marrë veprime konkrete për të siguruar zbatimin e të gjitha rekomandimeve;
6. GKK-ja duhet të angazhohet më shumë në promovimin e të drejtave LGBTI, të hartojë rregulla dhe procedura të tija, dhe të inicojë hartimin e planit të ardhshëm të punës;
7. Duhet të ketë një mekanizëm përcjellës për gjuhën dhe krimet e urrejtjes bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor pas rishikimit të KPRK-së;
8. OShC-të të marrin një rol me proaktivë në monitorimin dhe kërkimin e përgjegjësisë nga institucionet për të zbatuar ligjet, aktet nënligjore, strategjitë ekzistuese dhe planet e punës që lidhen me çështjet dhe të drejtat LGBTI.
9. Donatorë të caktuar duhet të jenë më të kujdesshëm në dhënien e granteve për projekte të organizatave LGBTI. Ata duhet të konsultohen me organizatat e LGBTI për aktivitetet që janë më relevante për lëvizjen LGBTI në Kosovë dhe të mos të imponojnë idetë e tyre për aktivitete që mund të mos jenë relevante. Qasja e tillë po krijon një lloj përshtypje që organizatat LGBTI janë projekte të orientuara nga donatorët;
10. Donatorë të caktuar duhet të inkurajojnë organizimin e takimeve koordinuese të donatorëve për çështjet e LGBTI;
11. Donatorë të caktuar duhet të gjejnë modalitete për të mbështetur strategjitë e organizatave të LGBTI në vend që të japin projekte të afat të shkurtër;
12. Donatorë të caktuar duhet të jenë të kujdesshëm kur përkrahin organizatat LGBTI dhe aktivitetet e tyre me angazhimin e ekspertëve dhe asistencës teknike. Ndonjëherë, disa nga këta ekspertë po shkaktojnë mëshunë dëm në lëvizje sesa në përkrahjen dhe avancimin e saj.

